

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.
(II. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHQYPTARE

348⁶
A
1-17

1-2

Kalinduer-Fruer ' 1941 XIX.
VJETI XVII.
S H K O D E R

Pajtimi per të perkohshmen „HYLLI I DRITËS“

Shqypni	Nji numer	Fr. 1.00	Nji vjetë	Fr. 10.—
Itali	» »	» 1.00	» »	» 10.—
Nder vende tjera . .	» »	» 1.40	» »	» 14.—

DREJTUER E ADMINISTRUES: A. BENEDIKT DEMA

PERMBAJTJA

P. BENEDIKT DEMA — Në dekë të drejtorit t' onë A. Gjergj Fishtës o. f. m.	PAGE 1
Fr. VINÇENC PRENUSHI — 30 Dhetuer	8
Pr. FILIP FISHTA — Për vdekjen e At Fishtës	13
ZEF M. HARAPI — Diq...	16
P. DONAT KURTI — Ftyra e ngrime	17
SHUK RADOJA — Gjendja ekonomike e Shkodres	20
GELASIU — Fjalori Toponomastik	31
Prof. FRANO ALKAJ — Iliada e Homerit	41
Prof. FILIP FISHTA — Gjurmimet e nji mueji në Rromë	46
BARDHYLI — Lushnja dhe Fshatrat per rreth sajë	58
D. ALEKSANDER SIRDANI — Frazellogji	70
P. ANTON HARAPI — Valë mbí valë	79
NDOC KIÇI — Muzika mjet qytetnues e kombtarizues	85
GIULIO BERTONI — Formimi i gjuhës letrare italiane	94
P. D. KURTI — Pralla. — Blë. II. Fash. 3.	



HYLLI I DRITËS

E PERKOHSHME KULTURALE-LETRARE

Në dekë të Drejtorit t' onë

A. GJERGJ FISHTËS O.F.M.

Mbarimi i vjetit 1940, dita 30 Dhetuer, shperdau në mbarë Shqypnín, në çdo skâj të sajín, jehin e kobshem, i cilli bredhte lajmin e zí, qi epej prej Kuvendit të Françeskanvet të Gjuhadorit në Shkoder: Át Fishta diq; diq Poeti Kombtár i Shqypnís! Çdo Shqyptari i dukej se kishte nji të dekun shi në voter të veten: heshti ajo gojë, qi këndoi trimnít e të Parvet, ajo dorë, qi shkrou Epopén mâ të larten e fisit shqyp-tár, u ngrí. Kombi humbi Apostullin e pamvarsís së vet, mprojsin e tagrevet të veta mâ shêjte. Hylli i dritës i Shqyp-nís u terratis prej njij lpêje së murrme.

Atë ditë kobi pershkojshem udhët e kryeqytetit t' onë per të rregullue nji çashtje të së Perkobshmes s' onë HYLLI I DRITËS. E kishem lânë mjaft të smût: zëmra më ndiete zí.

S' vonoi veç pak orë mbasi Át Fishta kishte ndrrue jetë, (n' oren nji pa nji të katert të natës), e të gjith banorve të kryeqytetit u mbrñiti në vesh lajmi i dekës së Shqyptarit të Madh, i Homerit të Shqypnís. Me krye lavierret, piklueshem, me sý të lotuem shum tjerë, i kumtojshin shoqit per brí: „A ndieve? At Fishta kishte ndrrue jetë sot në mgjes!“

Kah mjesdita mblidhej populli çeta-çeta per rreth Ba-shkije, nen megafonin, qi me zâ të kumueshem shperdate ligji-raten e permortshme të z. Prof. Karl Gurakuqit: s' luete ve-ndit deri qi oratori u dha fund fjalvet të veta, dalë prej zëmre së njij ish-xânsi të Poetit, qi u zhduk prej nesh.



